



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Komuna Vushtrri
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim

të pronës së paluajtshme Komunale

Nr.03/2016

Dt.10.11.2016

Në bazë të nenit 5 dhe 8 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 4,7 dhe 8 të Rregullores QRK NR.23/2013 Për përcaktimin e procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, nr.01Nr.74/16 të dt.28.04.2016, Komuna e Vushtrrisë shpallë këtë:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUJTSHME KOMUNALE

NENI 1: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK Komuna Vushtrri Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale	Personi kontakt: Bedri Dobra tel.044/212-646 Ilirjana Azemi tel.044/347-419
Adresa SHESHI ‘‘HASAN PRISHTINA’’	Kodi postar 42000
QYTETI Vushtrri	Komuna Vushtrri
E-mail pronatkomunale@gmail.com	

NENI 2: LËNDA E ANKANDIT

Komuna e Vushtrrisë-**Komisioni Komunal për dhënie në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale**, në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, nr.01Nr.74/16 të dt.28.04.2016, ka përcaktuar dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për parkingje përmes procedurës së ofertave të mbyllura.

Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme komunale, si në vijim:

1. Në Zonën e parë dhe të dytë përfshihen këto vend parkingje:

*Ngastra kadastrale 504 dhe 505 të ish stadiumi i hendbollit me sipërfaqe prej 1225m², me kapacitet prej 40 vend parkimeve;

*Shiriti i ndarë i ngastrës kadastrale 1116 i rrugës ‘‘Dëshmorët e Kombit’’ me kapacitet prej 69 vend parkimeve;

*Shiriti i ndarë i ngastrës kadastrale 3536 i rrugës ‘‘Gjergj Kastrioti-SKENDERBEU’’ me kapacitet prej 92 vend parkimeve;

2.Në Zonën e tretë përfshihen këto vend parkingje:

*Shiriti i ndarë i ngastrës kadastrale 1102 i rrugës ‘Kruja’ me kapacitet prej 10 vend parkimeve;

*Shiriti i ndarë i ngastrës kadastrale 1127 i rrugës ‘Halit Quka’ me kapacitet prej 12 vend parkimeve;

3.Të drejt pjesëmarrjes kanë personat fizik dhe personat juridik;

4.Kriteri i dhënies së kontratës :Oferta e përgjithshme me çmimin më të lart;

5.Çmimi fillestar për një vend parking në muaj për Zonën e I- parë dhe të II-dytë është 2 euro apo kapaciteti për 40 vend parkime çmimi fillestar është 80 €.

Në ngastrën kadastrale 1116 me kapacitetet prej 69 vend parkimeve çmimi fillestar për muaj është 138 € .

Në ngastrën kadastrale 3536 me kapacitetet prej 92 vend parkimeve çmimi fillestar për muaj është 184 € .

Çmimi fillestar për një vend parking në Zonën e III- tretë për 1 muaj është 1.50€

Apo

Në ngastrën kadastrale 1102 me kapacitetet prej 10 vend parkimeve çmimi fillestar për muaj është 15 € .

Në ngastrën kadastrale 1127 me kapacitetet prej 12 vend parkimeve çmimi fillestar për muaj është 18 € .

6.Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës është 5 vite.

Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme komunale, si vijon :

1.Ngastra Kadastrale nr. P-70202028 – 00067 - 0 , Zona Kadastrale Stanofc i Poshtëm, në sipërfaqe prej 02.03.85 ha, pronë e Komunës së Vushtrrisë

2.Ngastra Kadastrale nr. P-70202022 – 00142 - 0, Zona Kadastrale Stanofc i Poshtëm, në sipërfaqe prej 01.02.35 ha, pronë e Komunës së Vushtrrisë

3.Të drejt pjesëmarrjes kanë personat fizik dhe personat juridik

4.Kriteri i Dhënies së Kontratës : Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lartë.

5. Çmimi fillestarë për 1 ha është 50.00€/ 1 ha.

6. Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës është 10 vite.

7. Veprimtaria që ushtrohet në tokat e dhëna në shfrytëzim është veprimtari bujqësore, kryesisht për kultura lavërtari.

NENI 3: AFATET DHE PROCEDURAT

1. Ankandi Publik është i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes së Ankandit;
2. Afati kohorë i fundit për tërheqjen e dokumentacionit të ankandit është data: 08.12.2016 ora 15:00
3. Afati kohorë për dorëzim-pranimin e aplikacioneve është data: 09.12.2016 , më së largu deri në ora 14:00 vendi Komuna e Vushtrrisë ,zyra e pranimit-arkiva,zyra nr.1 kati përdhese.
4. Ofertata duhet dorëzuar të mbyllura; tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në formë fizike dhe elektronike nëpërmes E-mail:pronatkomunale@gmail.com.
5. Takimi për hapjen e aplikacioneve bëhet me datën:06.12.2016 , vendi Salla e Kuvendit Komunal – Vushtrri.
6. Informacionet shtesë mund ti kërkoni te z.Bedri Dobra ,Drejtoria e Kadastrit Gjeodezisë dhe Pronës dhe znj.Ilirjana Azemi ,Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.